

## E DREJTA PËR INFORMIM

### Forcimi i transparencës proaktive, trajnim online me koordinatore për të drejtën e informimit



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi trajnimin online mbi “Të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit dhe regjistrin elektronik për kërkesat dhe përgjigjet”. Qëllimi i tij ishte diskutimi për forcimin e transparencës proaktive të autoriteteve publike nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të informacionit/dokumentacionit në faqet e tyre zyrtare të internetit.

Në këtë trajnim, me pjesëmarrjen e koordinatoreve për të drejtën e informimit nga institucione qendrore e të varësisë apo të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, vëmendje ju kushtua edhe përdorimit të portalit “pyetshtetin.al” dhe regjistrin elektronik për kërkesat dhe përgjigjet për të drejtën e informimit (REKPDI) të instaluar në të. Gjithashtu, u trajtuan edhe tematika të tilla, si: hartimi, plotësimi dhe përditësimi i programit të transparencës; roli i koordinatorit në procesin e informimit të publikut; procedura e trajtimit të një kërkesë për informim; u trajtuan raste konkrete nga praktika në optikën e ligjit të përmirësuar për të drejtën e informimit.

### Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

**Vendim Nr. 5** - Bashkia Tiranë

**Vendim Nr. 6** - Për sanksionin e titullarit të Autoritetit Publik/Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a

**Vendim Nr. 7** - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit mars 2024.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit mars 2024, ka dhënë 3 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Ndryshimet ligjore të LDI, (të cilat hynë në fuqi në nëntor të vitit të kaluar) përcaktojnë detyrime, përgjegjësi dhe kundrvajtje të reja administrative si në rastin e moszbatimit të vendimit të Komisionerit kur ky i fundit ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, sipas përcaktimeve të pikës 6/1 të nenit 24 këtij ligji.

Vendimi i ilustruar më poshtë, përcakton rastin e parë, kur kjo dispozitë gjen praktikë në vendimarrjen e Komisionerit.

Me vendim nr. 06, datë 29.03.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik/Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizimeve Dibër sh.a (në vijim "Autoriteti Publik").

Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe parashtrimeve të dhëna nga Autoriteti Publik, Komisioneri ka dalë me vendim urdhërimi.

Zyra e Komisionerit, ka vendosur të urdhërojë Autoritetin Publik për të vënë në dispozicion të ankuesit dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.12.2023.

Në tejkallim të afatit të përcaktuar nga Komisioneri, për zbatimin e vendimeve të sipërcituara, ankuesi, ka njoftuar se: "Autoriteti Publik ka respektuar vendimet me nr. 55 dhe 57 duke sjellë një informacion të "cunguar", por që i konsideron gjithsesi të përmbushura. Ndërkohë, vendimet me nr. 54, datë 07.12.2023, nr. 56, datë 11.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 kanë mbetur pa u zbatuar nga Autoriteti Publik".

Në këto kushte, ankuesi, kërkon marrjen e masave përkatëse nga Komisioneri, bazuar në parashikimet e LDI. Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes bazuar në pikën 6/1 të nenit 24, të LDI, në të cilin parashikohet se: "Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij", kërkoj të informohet në lidhje me procedurën e ndjekur nga Autoriteti Publik pas vendimarrjes së sipërcituar, brenda datës 12.02.2024.

Autoriteti Publik, ka sqaruar Komisionerin se: "...pas zhvillimit të seancës dëgjimore të mbajtur në zyrat e Komisionerit, është dorëzuar i gjithë informacioni i kërkuar në formën e një kthim përgjigje mbi çdo kërkesë lidhur me të drejtën e informimit të kërkuar nga ana e ankuesit, dorëzuar në zyrat e Protokoll/Arkivës të këtij institucioni, duke zbatuar në këtë mënyrë dhe vendimin e Komisionerit".

Shkresa këto të cilat, edhe pse Autoriteti Publik ka pasur detyrimin për t'ja vendosur vetë në dispozicion palës ankuese, këtij të fundit, i'a ka vendosur në dispozicion Zyra e Komisionerit të gjithë informacionin e përcjellë nga Autoriteti Publik duke

kërkuar qëndrimin përkatës nëse informacioni i vendosur në dispozicion është apo jo në përputhje me vendimarrjen e sipërcituar.

Nisur nga këto fakte dhe deklaratimet e ankuesit, Komisioneri ka bërë me dije titullarin e Autoritetit Publik se: "...ankuesi ka vijuar me ankimin, me anë të të cilit pretendon se: "...pas verifikimit me kujdes të informacionit të sjellë - skanuar nga Zyra e Komisionerit... rezulton se është përmbushur vetëm vendimi me nr. 56, ku në një paragraf të shkresës së Autoritetit Publik me nr. 1189 prot., datë 16.11.2023 thuhet se nuk i disponojnë dokumentet e kërkuara. Ndërkohë, vazhdon të mos zbatohet vendimi numër 54, 58 dhe 59 i Komisionerit."

Në këto kushte, ka sjellë në vëmendje të tij se: "Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Publik, si dhe të personit përgjegjës bazuar në LDI, duhet të vendosë në dispozicion të Zyrës së Komisionerit, provat përkatëse nëpërmjet të cilave vërteton vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, në përputhje me vendimet nr.54, datë 07.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 11.03.2024".

Në vijim, titullari i Autoritetit Publik nuk ka kthyer asnjë përgjigje në lidhje me qëndrimin e kërkuar nga Komisioneri.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion pas vendimeve përkatëse, si dhe qëndrimit të parashtruar nga ankuesi, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik nuk arriti të provojë vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Rrjedhimisht, rezulton se Autoriteti Publik nuk ka zbatuar vendimet me nr. 54, datë 07.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kundërshtim kjo, me pikën 6/1 të nenit 24, të LDI, në të cilin parashikohet se: "Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij".

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, sanksionimin e Titullarit të Autoritetit Publik, për moszbatimin e vendimeve me nr. 54, datë 07.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 të Komisionerit, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 1 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).



## **Këshilli i Evropës organizon aktivitet në kuadër të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit**

Në cilësinë e organizatorit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners) në Shqipëri, Zyra e Komisionerit bashkëpunon me Këshillin e Evropës mbi organizimin e një aktiviteti paralel në kuadër të punimeve të Konferencës gjatë sesionit të hapur, me temë: “Konventa e Këshillit të Evropës mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare – Vlerësimi fillestar”.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Në vitin 2009, Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (CETS Nr.205), e njohur gjithashtu si Konventa e Tromsø, u bë instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar detyrues që njeh të drejtën e përgjithshme të pavarur për të aksesuar informacionin të zotëruara nga autoritetet publike. Konventa e Tromsø ka hyrë në fuqi në 1 dhjetor 2020, pas ratifikimit të saj nga 10 vende.

Ky aktivitet do të rrisë ndërgjegjësimin për standardet e Konventës së Tromsø-s dhe do të prezantojë vlerësimin bazë të Grupit të Informimit të Aksesit të Këshillit të Evropës të 11 palëve të para në Konventë: Bosnja dhe Hercegovina, Estonia, Finlanda, Hungaria, Islanda, Lituania, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Norvegjia, Suedia dhe Ukraina. Gjithashtu, do të eksplorojë sinergjitë dhe do të stimulojë reflektimet mbi bashkëpunimin e mundshëm ndërmjet Grupit të Informimit për akses të Këshillit të Evropës dhe Komisionerëve të Informimit.

Grupi përbëhet nga ekspertë të pavarur dhe të paanshëm dhe është përgjegjës kryesor për monitorimin e zbatimit të Konventës nga palët e tij. Për më shumë informacion lidhur me ekspertët dhe temat që do të prezantohen në këtë aktivitet ju ftojmë të konsultoni faqen zyrtare të Konferencës mbi baza të vazhdueshme.

## Bashkëpunimi rajonal për garantimin e të drejtave të qytetarëve

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte pjesë e shkëmbimit të eksperiencave mes Shqipërisë dhe Bosnjë Hercegovinës në kuadër të organizimit të zgjedhjeve.



Një delegacion me përfaqësues të disa institucioneve të këtij vendi, zhvilloi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një vizitë studimore, për t'u njohur me projektin e votimit dhe numërimit elektronik të zbatuar në Shqipëri apo edhe sfidave në organizimin e procesit zgjedhor.

Kontributi i Zyrës së Komisionerit në këtë aktivitet kishte të bënte me njohjen e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe praktikën e bashkëpunimit të frytshëm me KQZ për hartimin e akteve të tjera rregullatore në funksion të tij. Një proces zgjedhor gjithëpërfshirës dhe transparent duhet të mbajë në konsideratë edhe aspektin ndërgjegjësues për qytetarët, në mënyrë që ata të ushtrojnë dhe t'u garantohen plotësisht të drejtat e tyre.

### Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania